



Instituti Kombëtar i Fizikës – Akademia e Shkencave

- **Çfarë është?**

Instituti Kombëtar i Fizikës (IKF) është njësi bashkëpunimi dhe koordinimi shkencor në fushat e fizikës, me mision nxitjen e dijes e të vërtetës shkencore, mbrojtjen e shëndetit publik, trashëgimisë kulturore, mjedisore dhe materiale, nxitjen e teknologjisë dhe inovacionit, përmirësimin e programeve të studimit universitar, zhvillimin e fizikës si shkencë themelore, në bashkëpunim me Institutet, Akademitë e tjera dhe institucione të mirëfillta shkencore.

IKF funksionon kryesisht përmes faqes elektronike www.ikf-akad.al, Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

IKF synon promovimin e dijeve më bashkëkohore në fushën e fizikës në të gjithë hapësirën mbarëshqiptare, lehtësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit mes fizikanëve shqiptarë kudo në botë, rritjen e aksesit dhe lidhjes mes fizikanëve shqiptarë dhe të huaj, mbështetjen e ekselencës shqiptare në kërkim e mësimdhënie, me fokus talentet e reja.

IKF synon të krijojë një zë aktiv dhe autoritar në mjedisin kombëtar të fizikës dhe të shërbejë si qendër e komunitetit të shqiptarëve të diplomuar në fizikë. Në fokusin e aktiviteteve të IKF bën pjesë edhe fizika shkollore, përmes bashkëpunimit dhe nxitjes së mendimit kritik ndërmjet aktorëve kryesorë, në dobi të përmirësimit të mësimdhënies së fizikës; përmes aktiviteteve të tilla si trajnimi i çertifikuar i mësuesve; përmes përfshirjes së mësuesve të fizikës dhe nxënësve të talentuar në grupe aktive për popullarizimin e shkencës.

- **Aktivitetet kryesore të IKF**

1. Organizim konferencash, takimesh kombëtare dhe ndërkombëtare, forumesh tëndryshme diskutimi online apo onsite në fushën e fizikës.
2. Afrim i fizikanëve të huaj me mjedisin shkencor mbarëshqiptar, shoqëruar meçertifikime të tilla honorifike, si p.sh. "Bashkëpunëtor i ASH".
3. Mbajtje leksionesh të hapura online sipas tematikave të ndryshme, nga fizikanëshqiptarë dhe të huaj.
4. Krijim grupesh më të ngushta të interesit sipas një fushe të caktuar të fizikës.
5. Hartim studimesh, projektesh e propozimesh për organet shtetërore, në lidhje më zhvillimin e fizikës në hapësirën shqiptare si dhe deklaratah mbi pozicionin e IKF- së në lidhje më çështje të kërimit, financimit të tij, inovacionit dhe mësimdhënies në fizikë.
6. Organizim kursesh online dhe onsite, si dhe aktiviteteve të tjera, me synim përmirësimin e mësimdhënies së fizikës në hapësirën mbarëkombëtare.
7. Organizim kursesh të ndryshme të edukimit në distancë.
8. Organizim takimesh për nxitjen dhe këshillimin e karrierës në fizikë.



9. Përditësim i të reja me të fundit shkencore në faqen web.
10. Hartim dhe botim online informacionesh të thjeshtuara për publikun.
11. Krijim i një biblioteke të pasur videokonferencash, sipas drejtimeve të ndryshme të fizikës.

- **Organizimi i IKF**

IKF drejtohet nga një bord, ku bëjnë pjesë të gjithë anëtarët fizikanë të Akademisë së Shkencave dhe disa fizikanë shqiptarë jashtë Shqipërisë.

Bordi cakton një Drejtor Ekzekutiv, i cili ndryshohet sa herë që bordi e vendos me shumicën e tij të thjeshtë.

Anëtarët e IKF vijnë nga komuniteti shqiptar i fizikanëve të angazhuar në sferën akademike, në ekonomi, në mësimdhënie. Edhe studentët e kushdo tjetër që shfaq interes në fizikë mund të jetë anëtar i IKF. Anëtarësimi realizohet me kërkesë të personit të interesuar dhe miratohet nga bordi.

IKF është strukturë që funksionon brenda Akademisë së Shkencave (ASH). IKF përdor logon e ASH në të gjitha komunikimet. ASH nderon me çertifikata bashkëpunëtorët e IKF.

- **Buxheti i IKF**

Megjithë kontributin vullnetar të bordit, drejtimin ekzekutiv apo studentëve, IKF ka buxhetin e vet, i cili përmban zëra që duhet të mbulojnë këto shpenzime:

1. Ndërtimin, mirëmbajtjen dhe pasurimin e faqes online.
2. Honoraret për leksionet online apo offline dhe aktivitetet e tjera të trajnimit dhe popullarizimit të shkencës.
3. Mbështetjen për studentët e talentuar.
4. Çdo aktivitet tjetër në përputhje me misionin e tij.

- **Burimet financiare**

ASH financon një buxhet vjetor për funksionimin e IKF.

Burime të tjera janë fondet e kërkimit shkencor për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, institucione të huaja në Shqipëri, etj. Burim financimi janë edhe të ardhurat nga fee-të e konferencave dhe shërbimet e trajnimit të mësuesve, kuota e anëtarësimit dhe çdo burim tjetër i ligjshëm.